





SYLABUS

PROGRAMI MËSIMOR

ADMINISTRIMI PUBLIK DHE MENAXHIMI I RESURSEVE
NJEREZORE

**LËNDA: NDRYSHIMET SOCIALE DHE
GLOBALIZIMI**

VITI AKADEMIK 2022/2023

PROGRAMI STUDIMOR:ADMINISTRIMI PUBLIK DHE MENAXHIMI I RESURSEVE NJEREZORE

EMRI I LËNDËS: NDRYSHIME SOCIALE DHE GLOBALIZIMI

FAKULTETI: Fakulteti i Shkencave Sociale

DEPARTAMENTI: Administrimi Publik dhe Menaxhimi i Resurseve Njerezore

SHIFRA E LËNDËS:

NIVELI & STATUSI: 6 ECTS Kredi
Studime deridiplomike/ VJESHTË 2022
2 orë Ligjeratë/ 2 orë ushtrime

LIGJËRUESI I LËNDËS: Dr. Deniz Memedi
E-mail: deniz.memedi@unt.edu.mk

ORËT E KONSULTIMEVE: Objekti B–SH.F. Kongresi i Manastirit:
E Shtunë, 00:00-00:00

ORARI I MËSIMDHËNIES: Ligjeratat:
E hënë 16:00 -17:30, Klasa B6
Ushtrimet:
E hënë 17:45-19:15, Klasa B6

Google Classroom

Si instrument kryesor për komunikim do të shfrytëzojmë Outlook/Gmail dhe Google Classroom-in. Kontrollimi i email-it dhe Classroom-it është i detyrueshëm.

Datat e provimeve dhe informata tjera të rëndësishme për fakultetin do të publikohen në (Google-Classroom) Info Fakulteti i Shkencave Sociale

KONTURAT E LËNDËS DHE QËLLIMET

Kjo lëndë është krijuar për t'u dhënë studentëve thellësinë dhe gjerësinë e nevojshme për të kuptuar procesin e ndryshimeve sociale dhe globalizimit që tani po ndikon në të gjitha vendet e globit pa përjashtim. Nëpërmjet kësaj lënde fokusi do të orientohet në analizën e dinamikave socio-ekonomike dhe politike që qëndrojnë në themel të praktikave të sotme të globalizimit; dmth prirja drejt shfaqjes së një tregu të integruar botëror për kapitalin, mallrat, shërbimet dhe punën. Nëpërmejt kësaj lënde do të shqyrtohet se si globalizimi ka ndikuar jo vetëm tregun botëror, por edhe në cdo qenie njerëzore anembanë globit. Çfarë impakti ka globalizimi për sa i përket demokracisë, kulturës, ekonomisë, zhvillimit dhe punës, jetës së përditshme të njerëzve me ngjyrë dhe eco -sistemit? Së fundmi, kjo lëndë do të shqyrtojë në baza javore se çfarë do të thotë për të gjithë ne të jemi qytetarë globalë.

Kjo lëndë ka disa qëllime kryesore edhe atë:

- Të analizojë dhe zbërthej konceptet e "ndryshimeve sociale" dhe "globalizimit" përmes thjerrëzave analitiko-shkencore..
- Të ndihmojë studentët të ndërgjegjësohen për rëndësinë thelbësore të vendndodhjeve dhe staturave sociale - veçanërisht në lidhje me rolin tonë si qytetarë globalë.
- Të inkurajojë kërkimin kritik të përvojës personale, mbi-përgjithësisht dhe kuptimeve të thjeshtuara të globalizimit dhe botëve tona të përditshme.
- Të shqyrtojë çështjet dhe çështjet kritike me të cilat përballet shoqëria jonë sot.
- Të njohim rolin tonë në ndryshimet shoqërore dhe aktivizmin social.

Përmbajtja e lëndës përbëhet nga 15 njësi mësimore duke ja bashkangjitur edhe orët praktike.

Mësimi i lëndës "Ndryshime Sociale dhe Globalizimi" do t'ju ofrojë:

- Të mësojnë esencën e koncepteve "Ndryshimet Sociale" dhe "Globalizimi". Të mësuarit e kësaj lënde do ti shtytë studentët që këtë lëndë ta kuptojnë si domosdoshmëri që di mundësojë të dhëna të reja për sa i përket zhvillimeve të fundit në kontekst global.
- Të aftësohen studentët që informatat e fituara ti shfrytëzojnë për të dhënë vlerësime dhe për të konstruktuar argumente.

REZULTATET E NXËNIES

Përshkrimi i i deskriptorëve për rezultatet e nxënies për këtë lëndë:

KATEGORIA	REZULTATET E NXËNIES	METODOLOGJIA VLERËSIMIT	%
Njohuritë dhe të kuptuarit	<ol style="list-style-type: none">1. Studentët do të demonstrojnë njohuri dhe kuptim në funksionalizimin e koncepteve kyçe të disiplinës shkencore të "Ndryshimeve Sociale dhe Globalizim".2. Do të identifikojnë ndikimin e tendencave globale mbi kombet, sistemet ekonomike, organizatat dhe praktikat e biznesit.3. Do të njohin Institucionet kryesore të përfshira në globalizim dhe rolet e tyre specifike në sistemin global.	<ol style="list-style-type: none">1. Kolokuiumi i parë2. Kolokuiumi i dytë	40 40
Zbatimi i njohurive dhe të kuptuarit	<p>Aftësia e studentëve për ti përdorur konceptet dhe njohuritë teorike të lëndës gjatë:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Komunikimin e përditshëm;2. Intervistave;3. Përgatitjes së teksteve të shkruar;4. Përshkrimit të situatave të përgjithshme dhe specifike	<ol style="list-style-type: none">1. Aktiviteti në klasë	5
Sjellja e gjykimeve	<p>Vlerësimi i studentëve për të gjykuar nëse duhet të përdorin njohuritë e caktuara në një situatë të caktuar ose tekst të shkruar.</p> <p>Si propozime plotësuese për përdorimin e njohurive dhe terminologjisë së duhur me studentët, kemi:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Diturinë - studentët duhet të kenë parasysh listën e ngjarjeve kryesore, për të treguar, përmendur, përshkruar, ndërlidhur, shkruar, gjetur, deklaruar një ngjarje;2. Kuptimin - përmes shfaqjes së	<ol style="list-style-type: none">1. Ese2. Prezantim/Përshkrim3. Detyra	5

	<p>pikturave të vizatuara, studentët të arrijnë të shpjegojnë, interpretojnë, përmbledhin, diskutojnë, dallojnë, parashikojnë përsëritin, përshkruajnë një ngjarje;</p> <p>3.Analizimin - studentët përmes krijimit të pyetësorëve/pyetjeve të arrijnë tek të dhënat e nevojshme për të analizuar, dalluar, studiuar, krahasuar, shpjeguar rrjedhjen e një ngjarje;</p> <p>4.Vlerësimin - përmes përgatitjes së nevojshme, studentët të arrijnë të vlerësojnë, zgjedhin, vendosin, arsyetojnë, debatojnë, dëshmojnë, argumentojnë, rekomandojnë rreth një ngjarje të zgjedhur.</p>		
Shkathësitë komunikuese	1. Demonstrim të aftësive komunikuese, siç janë komunikimi me shkrim dhe komunikimi gojor	1. Aktiviteti dhe punë në grupe	5
Shkathësitë e të mësuarit	1. Analizë kritike të rasteve të caktuara që janë të lidhura me materien e lëndës.	1. Aktiviteti në klasë dhe mendimi kritik i studentëve	5
Totali			100

PËRSHKRIM PËRMBLEDHËS I VLERËSIMIT

PËRSHKRIMI	%
Prezenca	5
Aktiviteti	10
Detyrat e shtëpisë	
Detyra tjera	0
Punim seminarik	5
Rast studimi	0

Prezantim	0
Ese	0
Punim laboratorik	0
Projekt	0
Kolokfiumi 12 (në rast se studenti nuk kalon njërin nga dy kolokfiumet, ai i nënshtrohet provimit)	40
Kolokfiumi 2 (në rast se studenti nuk kalon njërin nga dy kolokfiumet, ai i nënshtrohet provimit)	40
Provimi përfundimtar	80
Totali	100

DETAJE PËR INSTRUMENTET E VLERËSIMIT

METODAT E MËSIMDHËNIES DHE NXËNIES

Mësimdhënia do të realizohet në mënyrë interaktive me punë në ekipe, diskutime dhe debate për tema të përshtatshme, lexim dhe analizë të librave të caktuar që trajtojnë tema nga studimet të fushës.

Si ndihma vizuale do të përdoren forume on-line për diskutim përmes Google Class., prezantime në Power-Point, dokumente burimore për analiza krahasuese të rregulloreve dhe politikave të ndryshme nga sfera e studimeve ndërkulturore.

Në çdo orë do të analizohen detyrat e dhëna nga klasa e mëparshme dhe do të diskutohet në formë të vërejtjeve kritike, argumenteve pro dhe kundër pikëpamjeve të paraqitura dhe reagimeve ndaj tezave të paraqitura.

KOLOKFIUMET & PROVIMET

Vlerësimi do të realizohet nëpërmes kolokiumit të parë, të dytë dhe provimit përfundimtar në rast se studenti nuk i kalon të dy kolokfiumet.

Pyetjet mundet të kenë njëri nga format vijuese:

- Zgjedhje e shumëfishtë
- Saktë/gabim
- Plotëso vijat e zbrazta
- Përgjigje të shkurta ndaj pyetjeve të parashtruara

PROJEKTET

Studentëve u kërkohet të përgatisin një punim seminarik për një temë të zgjedhur nga kurrikula e lëndës dhe ta prezantojnë përpara studentëve tjerë në klasës.

Vlerësimi i prezentimit do të mer për bazë kriteriumet vijuese:

- Kohëzgjatja
- Aftësija për ta mbajtur vëmendjen e grupit studentorë
- Shfrytëzimi i mjeteve vizuale
- Teknika tjera të komunikimit
- Përshtypje të përgjithshme

PREZENCA DHE RREGULLAT

Studentët duhet të jenë të pranishëm në ligjerata. Në kuadër të ligjerata, ata duhet të:

- Marrin pjesë në diskutime dhe punës në grup.
- Të analizojnë materialet video nga You tube për lëndët e përmbajtjes mësimore.
- Të realizojnë kuize pas përfundimit të fushave tematike.
- Të analizojnë dhe komentojnë një pyetje të caktuar në një kohë të caktuar gjatë ushtrimeve.

- Analizojnë pyetje të formuluar kërkimore.
- Për t'u përfshirë në mënyrë aktive në klasë, studentët pritët të lexojnë paraprakisht njësitë tematike të shpallura dhe të përdorin literaturë më të gjerë.

Plagjiatura, etika akademike dhe standardet e sjelljes

Politika e Integritetit akademik do të aplikohet në kuadër të kësaj lënde. Për shkelje të integritetit akademik si në vijim do të mërën masa adekuate.

Shkelja e integritetit akademik përfshin një ose më shumë nga gjërat në vijim:

- Kopjimi gjatë provimit nga një student tjetër
- Përdorimi i shënimeve ose librave të palejuara gjatë provimit
- Shkëmbimi i informatave më një student tjetër gjatë provimit
- Plagjiatura e punimeve të huaja
- Dhënja e deklaratave të rrejshme për të arsyetuar dike nga mësimi apo provimi.

TABELA E SHKALLËS SË NOTAVE

SHKALLA E NOTAVE	PËRSHKRIMI	NOTA
91% - 100%	Mrekullueshëm	10 (Dhjetë) A
81% - 90%	Shkëlqyeshëm	9 (Nëntë) B
71% - 80%	Shumë mirë	8 (Tetë) C
61% - 70%	Mirë	7 (Shtatë) D
51% - 60%	Mjaftueshëm	6 (Gjashtë) E
0% - 50%	Pamjaftueshëm	5 (Pesë) FX
	E pakryer *	IN
	Pa të dhëna *	NR

BIBLIOGRAFIA

TEKSTET PËR LEXIM (TEKSTET THEMELORE)

TË DETYRUESHME:

Titulli: Globalization – A Very Short Introduction

Autori: Manfred B.Steger

Botuesi: Oxford University Press

Viti: 2008

Titulli: Globalizmi

Autori: Adrian Civici

Botuesi: UET Press

Viti: 2012

MATERIALE SHITESË

Titulli: Social Change and Modernity

Autori: Hans Haferkamp and Neil J. Smelser

Botuesi: UNIVERSITY OF CALIFORNIA PRESS

Viti: 1992

Titulli: Social Change and Modernity

Autori: Hans Haferkamp and Neil J. Smelser

Botuesi: UNIVERSITY OF CALIFORNIA PRESS

Viti: 1992

Titulli: Six Faces of Globalization: Who Wins, Who Loses, and Why It Matters

Autori: by Anthea Roberts and Nicolas Lamp

Botuesi: Harvard University Press

Viti: 2021

Puja Mondal, "Top 5 Theories of Social Change – Explained",

<https://www.yourarticlelibrary.com/sociology/top-5-theories-of-social-change-explained/35124>, [10.09.2022].

ORARI TENTATIV

JAVA	MODULET	PËRSHKRIMI
JAVË PËR MESIMDHËNIE DHE MESIMNXËNIES		
1	TEKSTET PËR LEXIM	Sillabusi dhe literatura e përdorur në kuadër të lëndës
	LIGJËRATAT	Prezantimi i plan-programit, përfshirë syllabusin, literatura, mënyra e notimit dhe obligimet e studentëve gjatë semestrit.
	USHTRIMET	Njoftim me studentët
	NGARKESA E STUDENTIT	/
2	TEKSTET PËR LEXIM	Indira Gandhi National Open University, "Social Change", fq.43-56., https://egyankosh.ac.in/bitstream/123456789/18832/1/Unit-33.pdf ; Theo Spanos Dunfey, "What is Social Change and Why Should We Care?", Southern New Hampshire University, https://www.snhu.edu/about-us/newsroom/social-sciences/what-is-social-change .
	LIGJËRATAT	Ndryshimet sociale
	USHTRIMET	Saqrime ne lidhje me pergatitjen dhe perzgjedhjen e punimit seminarik.
	NGARKESA E STUDENTIT	4 orë
3	TEKSTET PËR LEXIM	Puja Mondal, "Top 5 Theories of Social Change – Explained". Shariaj Ibna Mizan Shuprio, "Theories of Social Change", pp.1-19.
	LIGJËRATAT	Teoritë e Ndryshimeve Sociale
	USHTRIMET	Analizë të tekstit gazetareskë për ndryshimet sociale
	NGARKESA E STUDENTIT	4 orë
4	TEKSTET PËR LEXIM	Adrian Civici, Globalizimi , UET Press, fq.12-36
	LIGJËRATAT	Çfaë është Globalizimi? Debate, Qendrimet dhe Perkusizime reeth nje Koncepti Shume Dimensional
	USHTRIMET	Shikim dhe komentim te videos e shikuar nga platofrma youtube, ne lidhje me imapktin e globalizimit ne kontekst te pergjithshem
	NGARKESA E STUDENTIT	4 orë
5	TEKSTET PËR LEXIM	Manfred B.Steger , Globalization – A Very Short Introduction, fq.17-36.
	LIGJËRATAT	Historia e Globalizimit
	USHTRIMET	Analize dhe komentim te tekstit "Rrofte Globalizimi" nga autori Lee Howell
	NGARKESA E STUDENTIT	4 orë
6	TEKSTET PËR LEXIM	Manfred B.Steger , Globalization – A Very Short Introduction, fq.37-55.
	LIGJËRATAT	Dimenzioni Ekonomik i Globalizimit

	USHTRIMET	Studentet eksplorojnë faqet e internetit të OBT-së, Bankës Botërore dhe FMN-së. Detyrë e tyre është që të zgjedhin një organizatë. Duhet të përshkruajne shkurtimisht synimet dhe qëllimet e organizatës. Studentet duhet të shkruajne nga një paragraf duke përshkruar një sukses dhe një dështim (shembuj specifik, jo të dhëna të gjera kërkimore) të përpjekjeve të organizatës në arritjen e qëllimeve të saj.
	NGARKESA E STUDENTIT	4 orë
7	TEKSTET PËR LEXIM	Adrian Civici, Globalizimi , UET Press, fq. 249-270 Manfred B.Steger , Globalization – A Very Short Introduction, fq.56-68.
	LIGJËRATAT	Dimensioni Politik i Globalizimit
	USHTRIMET	Parapërgatitje për kolokfiumin 1
	NGARKESA E STUDENTIT	4 orë
9	TEKSTET PËR LEXIM	Manfred B.Steger , Globalization – A Very Short Introduction, fq.69-92.
	LIGJËRATAT	Dimensioni Kulturor i Globalizimit
	USHTRIMET	Analiza të përmbajtjes së teksteve mbi konfliktet globale kulturore në mediumet sociale.
	NGARKESA E STUDENTIT	4 orë
10	TEKSTET PËR LEXIM	Manfred B.Steger, Globalization – A Very Short Introduction, fq.93-112.
	LIGJËRATAT	Dimensioni Ideologjik i Globalizimit,
	USHTRIMET	Diskutim dhe analize të teksteve (gazeta / kolumna) mbi konceptin e globalizimit nën prizmin ideologjik.
	NGARKESA E STUDENTIT	4 orë
11	TEKSTET PËR LEXIM	Adrian Civici, Globalizimi , UET Press, fq. 183-192
	LIGJËRATAT	Globalizimi I Dijes dhe Informacionit
	USHTRIMET	Analize dhe diskutim i tekstit "Roli i teknologjisë për njerëzimin", https://telegrafi.com/roli-teknologjise-per-njerezimin/
	NGARKESA E STUDENTIT	4 orë
12	TEKSTET PËR LEXIM	Manfred B.Steger , Globalization – A Very Short Introduction, fq.113-130.
	LIGJËRATAT	Sfidat e Globalizimit
	USHTRIMET	Komentim të videos rreth sfidave aktuale të globalizimit, https://www.youtube.com/watch?v=UITJTGh1FVs
	NGARKESA E STUDENTIT	4 orë
13	TEKSTET PËR LEXIM	Manfred B.Steger , Globalization – A Very Short Introduction, fq.131-136.
	LIGJËRATAT	Vlerësimi mbi perspektivën e së ardhmes mbi globalizimin
	USHTRIMET	Parapërgatitje për kolokviumin II.
	NGARKESA E STUDENTIT	4 orë
JAVË PËR PROVIME DHE MËSIM KLINIK		

8	KOLOKFIUMI I	Ligjëratat deri në javën e shtatë
14	MËSIMI KLINIK	/
15	PROVIMI PËRFUNDIMTARË	Provimi përfundimtar

SHËNIM:

Java e provimeve dhe ajo e mësimit klinik mund të ndryshojnë.
